

Deklarata e të Drejtave të Punonjësve të Seksit në Europë

Parathënie

Kjo deklaratë është hartuar nga punonjësit e seksit dhe nga organizata të cilat punojnë në fushën e promovimit të të drejtave të njeriut dhe mirëqenies së përgjithshme për ta. Deklarata liston të drejtat të cilat janë për të gjithë qytetarët europianë, përfshirë edhe punonjësit e seksit; deklarata përshkruan edhe masat e praktikën e rekomanduara që firmëtarët e deklaratës besojnë se janë minimumi i nevojshëm për t'u siguruar që këto të drejta mbrohen dhe respektohen. Këto të drejta duhet të mbrohen dhe respektohen në zhvillimin e projekteve dhe programeve të dizenuara për çështje të tilla: si trafikimi, migrimi i pakontrolluar apo terrorizmi.

Deklarata

Të gjithë individët në Europë, përfshirë edhe punonjësit e seksit, kanë të drejtat e mëposhtme sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Të gjitha qeveritë europiane janë të detyruara të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin:

- I. E drejta për jetën, lirinë dhe sigurinë e personit.**
- II. E drejta për të qenë të lirë nga ndërhyrjet arbitrare në jetën private apo familjare, shtëpinë ose korrespondencën, dhe nga sulmet mbi ndershmërinë dhe reputacionin e një personi.**
- III. E drejta për një standart të arritshëm, fizik dhe mendor.**
- IV. E drejta për lirinë e lëvizjes dhe qëndrimit**
- V. E drejta për të qenë të lirë nga skllavëria, puna e detyruar dhe robëria.**

- VI. E drejta për të siguruar mbrojtjen e ligjit dhe mbrojtje nga diskriminimi, apo forma diskriminimi bazuar në racën, gjininë, kombësinë, orientimin seksual, etj.**
- VII. E drejta për t'u martuar dhe krijuar familje.**
- VIII. E drejta për të punuar, për zgjedhje të lirë të punës dhe për kushte të favorshme në punë.**
- IX. E drejta për grumbullime dhe shoqërime paqësore.**
- X. E drejta për t'u larguar nga një vend, përfshirë edhe atë të lindjes, dhe për t'u kthyer në atë vend.**

Këto të drejta të njeriut janë të përfshira në traktatet ndërkombëtare, të cilat qeveritë europiane kanë përkrahur dhe miratuar.

Për më tepër, shumica e traktateve përmbajnë çështje lidhur me mosdiskriminimin, duke theksuar që këto të drejta duhet të aplikohen pa diskriminuar bazuar në racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, besimin fetar, opinionet politike, origjinën sociale dhe kombëtare, etj. Si shtesë, komiteti i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara, ka vendosur komentim - "secila nga të drejtat e Konventës, duhet të garantohen pa diskriminim tek vendasit dhe të huajt".

Megjithëse këto të drejta aplikohen për të gjitha qeniet njerëzore, eksperiencat e punonjësve të seksit në Europë, dëshmon për mungesë të respektimit, mbrojtjes, përbushjes dhe promovimit të të drejtave të tyre, ashtu si të gjithë personat e tjerë.

Nëpërmjet kësaj deklarate, ne po bëjmë të ditur të drejtat e punonjësve të seksit në Europë, si dhe t'u kërkojmë qeverive europiane të sigurojnë miratim për këto të drejta.

I. Jeta, Liria & Siguria

Punonjësi e seksit, kanë të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personit, përfshirë edhe zgjedhjen e seksualitetit të tyre, dhe respektimin e këtyre të drejtave:

- 1.** Asnjë person nuk mund të detyrohet, nga persona të tjerë, të përfshihen në shërbime seksuale, kundër dëshirës së tyre, apo kushteve me të cilat nuk janë dakord.
- 2.** Prezervativët përbëjnë një mbrojtje të domosdoshme për jetën dhe sigurinë e tyre; ashtu sikurse duhet të ndalohej konfiskimi i prezervativëve nga punonjëset e seksit.
- 3.** Qeveritë duhet t'i japin fund mungesës së ndëshkimit për nivele të papërshtatshme të dhunës dhe vrasjeve ndaj punonjësve të seksit në të gjithë vendet, përfshirë edhe abuzimet me hetimin dhe ndëshkimin të kryera nga organet zyrtare të lidhura me zbatimin e ligjit.

II. Privatësia & jeta familjare

Punonjësit e seksit kanë të drejtën për të qenë të lirë nga ndërhyrjet arbitrare në jetën e tyre private dhe familjare, shtëpinë e korrespondencën dhe sulmet ndaj nderit e reputacionit, dhe për të respektuar këtë të drejtë:

4. Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie¹; emërtimi i partnerëve të punonjësve të seksit si 'pimps' është diskriminues, dhe dëshmon se punonjëset e seksit nuk kanë të drejtë të zhillojnë një jetë private dhe familjare, dhe që personat e tjerë nuk mund të kenë një marrëdhënie me punonjësit e seksit.
5. Punonjësit e seksit kanë të drejtën të përcaktojnë numrin e hapësirave për fëmijët e tyre. Përfshirja e dikurshme apo aktuale në seksin komercial nuk duhet të konsiderohet arsye për të penguar një person për t'u berë prind apo për t'u kujdesur për fëmijën e tij

III. Shëndeti

Punonjësit e seksit, pavarësisht nga statusi i imigrimit, kanë të drejtën të kenë një standart të arritshëm të shëndetit mendor dhe fizik, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe lidhur me këtë të drejtë:

6. Askush nuk mund të jetë subjekt i një vizite të detyruar lidhur me shëndetin seksual apo testimi për HIV. Të gjitha testet shëndetësore duhet të kryhen duke patur si qëllim kryesor promovimin e shëndetit dhe të të drejtave të personit të prekur.
7. Informacioni lidhur me shëndetin seksual dhe statusin HIV, duhet të mbahet konfidencial.

IV. Liria e lëvizjes

Punonjësit e seksit kanë të drejtën për lirinë e lëvizjes dhe të qëndrimit, dhe lidhur me këtë të drejtë:

8. Asnjë kufizim nuk mund të vendoset lidhur me lëvizjen e lirë të individëve brenda shtetit ku ata zhvillojnë veprimtarinë e seksit komercial.
9. Asnjë kufizim nuk mund të vendoset mbi lirinë e lëvizjes së individëve brenda shtetit apo komunitetit të tyre. Të gjithë rregullat, të çfarëdo niveli që kërkojnë kontrollë ndaj punonjësve të seksit, nuk duhet të ndërhyjnë në të drejtën për të lëvizur, përfshirë lirinë për t'u larguar dhe kthyer në një rezidencë të caktuar, takimin me familjen apo aksesin në shërbimet e ndryshme.

¹ Sipas Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e dretja e privatësisë përfshin "të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore, sidomos në sferën emocionale, për zhvillimin e personalitetit të një personi". *Dudgeon v Mbretërisë së Bashkuar*. Gjykimi i Gjyktës së të Drejtave të njeriut (1981) 4 EHRR 149.

V. Liria nga skllavëria dhe puna e detyruar

Punonjësit e seksit kanë të drejtën të jenë të lirë nga skllavëria, puna e detyruar dhe robëria. Lidhur me këtë të drejtë:

- 10.** Duhet të merren masa që punonjësve të seksit t'u përmbushen të drejtat e tyre të punës, të jenë të informuar për to dhe të kenë akses të plotë në masat dhe standarte të kënaqshme, si dhe për t'i dhënë fund shfrytëzimit prej të tjerëve.
- 11.** Duhet të merren masa për të siguruar një asistencë dhe mbrojtje të përshtatshme për viktimat e trafikimit, punës së detyruar dhe skllavërisë, duke ofruar respektim të plotë të të drejtave të tyre të njeriut. Duhet t'u sigurohet një akses efektiv në organet ligjore dhe të drejtësisë, përfshirë kompensimin, për detyrimin pa miratimin e tyre për të bashkëpunuar me drejtësinë. Personat e trafikuar nuk duhet të rikthehen në vende apo situata që mund të çojnë në rirafikimin e tyre, apo që rezultojnë në dëmtimin e tyre.

VI. Mbrojtje e barabartë nga ligji & Mbrojtja nga Diskriminimi

Punonjësit e seksit kanë të drejtën të kenë një mbrojtje të barabartë ndaj ligjit, përfshirë aksesin ndaj shërbimeve për heqjen dorë nga seksi komercial, sikurse dhe mbrojtjen ndaj diskriminimit të çfarëdo forme. Lidhur me këtë të drejtë:

- 12.** Aty ku punonjësi i seksit nuk ka kryer ndonjë shkelje dhe seksi komercial nuk konsiderohet i paligjshëm, mbrojtësit e ligjit nuk duhet të abuzojnë me autoritetin e tyre duke ndërhyrë apo dëmtuar punonjësit e seksit. Kur përfshihen në hetime kriminale ose arrestime, ligji duhet të respektojë të drejtat e të gjithë të akuzuarve, pavarësisht se janë apo jo punonjës seksi.
- 13.** Shtetet janë përgjegjës për hetimin, persekutimin apo për krime të tjera të kryera ndaj personave, pavarësisht nga përfshirja e tyre në seksin komercial, statusit imigrues, dhe duhet të merren masa për t'u siguruar se sistemi i drejtësisë kriminale të jetë në gjendje të japë përgjigjen efektive për krimet e raportuara nga punonjëse e seksit, përfshirë sigurimin e trainimeve për personelin shtetëror në këto pozicione. Të dhënat e punonjësve të seksit në procedimet kriminale nuk duhet të merren bazuar në statusin e tyre si punonjës seksi.
- 14.** Askujt nuk mund ti shkatërrohet apo dëmtohet prona nga agjensi të ndryshme shtetërore.

Bazuar në të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi:

- 15.** Asnjë person nuk mund të diskreditohet në gjyqe civile apo familjare për shkak të përfshirjes së dikurshme, apo aktuale, në seskin komercial.
- 16.** Duhet të merren masa për mbrojtjen e punonjësve të seksit nga diskriminimi lidhur me punësimin, strehimin, shërbimet ligjore, aksesin në shërbimet shëndetësore dhe sociale, trajtimi arbitrar nga shoqëritë e sigurimeve, etj.
- 17.** Duhet të sigurohet edukim objektiv dhe profesional, objektivat e të cilit duhet të jenë eliminimi i diskriminimit ndaj punonjësve të seksit.

VII. Martesa & krijimi i Familjes

Punonjësit e seksit kanë të drejtën të martohen dhe krijojnë familje. Lidhur me këtë të drejtë:

- 18.** Përfshirja e dikurshme apo aktuale në seksin komercial nuk duhet të kufizojë apo ndalojë punonjësit e seksit nga martesa me një partner të zgjedhur prej tyre, të gjejnë një familje dhe të rrisin fëmijë.
- 19.** Qeveria duhet të sigurojë se përfshirja e dikurshme apo aktuale në seksin komercial, nuk duhet të pengojë punonjësit e seksit dhe familjarët e tyre të kenë akses në shërbimet shëndetësore. Gjithashtu duhet të sigurojnë se autoritetet publike dhe shërbimet shëndetësore nuk shfaqin diskriminim ndaj punonjësve të seksit dhe familjarëve të tyre, si dhe të sigurojnë respektimin e të drejtës për privatësi dhe jetë familjare.

VIII. Puna & kushte të favorshme në punë

Punonjësit e seksit kanë të drejtën për të punuar, të zgjedhin punën dhe të kenë kushte të favorshme pune, si dhe mbrojtje nga papunësia. Lidhur me këtë të drejtë:

- 20.** Mungesa e njohjes së seksit komercial si punë dhe profesion ka disa rrjedhoja në kushtet e tyre të punës, dhe në mohimin e mbrojtjes siguruar nga legjislacioni evropian i punës.
- 21.** Punonjësit e seksit duhet të jenë në gjendje të caktojnë, pa asnjë nderhyrje apo presion nga persona të tjerë, natyrën dhe kushtet e shërbimeve seksuale të ofruara prej tyre.
- 22.** Punonjësit e seksit duhet të kenë një mjedis pune të sigurtë dhe të shëndetshëm; punonjësve të seksit duhet t'u ofrohet informacion i saktë lidhur me shëndetin dhe sigurinë. Po ashtu, asnjë punonjësi seksi nuk duhet t'i kërkohet të përdorë alkool apo droga si një kusht për punën e tyre.

23. Të gjithë personat duhet trajtohen me respekt në vendin e tyre të punës dhe të jenë të lirë prej dhunimit seksual; industria e seksit, ashtu si të gjitha punët e tjera, duhet të promovojë respekt dhe liri nga abuzimi për punonjësit e seksit.
24. Punonjësit e seksit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë në punë dhe të përfitojnë nga përfitimet e sigurimeve shoqërore, përfshirë raportet, ditët pushim në raste sëmundje të paguara, leje lindje të paguar, leje e zakonshme e paguar dhe përfitimi i pagesës nëse puna e tyre mbyllet, apo nëse vendosin të lënë këtë punë.
25. Punonjësit e seksit nuk duhet të diskriminohen lidhur me pagën pagesat e qirave, apo pagesat e tjera për ushqime apo shërbime.
26. Asnjë person nuk mund të ndalohet të punojë apo të largohet nga puna e seksit komercial.

IX. Mbledhja & shoqërimi paqësor

Punonjësit e seksit kanë të drejtën për shoqërimi dhe mbledhje paqësore. Lidhur me këtë të drejtë:

27. Përfshirja në seksin komercial nuk duhet të konsiderohet si një arsye për të kufizuar mundësinë e punonjësve të seksit për të bashkëpunuar, bashkuar dhe krijimin e organizmave për të shprehur opinionet e tyre, përfshirja në marrëveshje kolektive dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

X. Largimi dhe kthimi në një vend të caktuar

Punonjësit e seksit, kanë të drejtë për t'u larguar nga një vend përfshirë këtu edhe vendin e tyre, dhe të kthehen përsëri. Lidhur me këtë të drejtë:

28. Përfshirja në seksin komercial nuk duhet të konsiderohet si arsye për kufizimin e një personi nga e drejta për t'u larguar dhe për t'u kthyer në vendin e tyre dhe në çdo kthim duhet t'u ofrohet siguri dhe mbrojtje.

XI. Strehimi

Punonjësit e seksit kanë të drejtën të kërkojnë strehë dhe nuk mund të rikthehen në situata të një trajtimi çnjerëzor ose torture. Lidhur me këtë të drejtë:

29. Qeveritë duhet të marrin masa për të siguruar se përfshirja në seksin komercial nuk duhet të krijojë pengesa për të drejtën për strehim.

XII. Pjesëmarrja publike

Punonjësit e seksit kanë të drejtën të përfshihen në jetën publike dhe kulturore të shoqërisë. Lidhur me këtë të drejtë:

30. Punonjësit e seksit, ashtu si të gjithë personat e tjerë, duhet të kenë të drejtën për t'u përfshirë në hartimin e ligjeve dhe programeve që ndikojnë në punën dhe jetën e tyre.

Kjo deklaratë është miratuar dhe nënshkruar nga 120 punonjës të seksit dhe 80 përkatës nga 30 vende gjate Konferencës Europiane për Punën e Seksit, të Drejtat e Njeriut dhe Migracionin, të zhvilluar më 16 tetor 2005. Deklarata u paraqit në ditën e tretë të Konferencës që u drejtua nga Monika Frassoni, anetare italiane e Parlamentit Europian, të Gjëlberit – Aleanca e Lire Europiane në Parlamentin Europian, Grupi Konfederal i Bashkimit të Majtë – Te Gjëlberit e Majtë Nordike.



**INTERNATIONAL COMMITTEE ON THE RIGHTS OF
SEX WORKERS IN EUROPE**
I • C • R • S • E

P.O. Box 51319, 1007 EH Amsterdam, the Netherlands